



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtruesi i njohur KSHPK-ja (në tekstin e mëtejshëm) në seancën së 87-të, të mbajtur më 01.06.2023, morri vendimin vijues:

VENDIM

Procedura sipas lëndës me numër 12-4262/1 të datës 28.04.2022, është formuar sipas denoncimit me pohime për organizimit të iftarit nga ana e Ministrisë së -----, **NDËRPRITET.**

KSHPK përcaktoi se sipas Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, bëhet fjalë për pretendime nuk ka elemente për veprim kompetent të mëtutjeshëm sipas lëndës për arsye se pohimet nga denoncimi nuk janë vërtetuar.

Lënda me numër 12-4262/1 të datës 28.04.2022 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Nga një parashtruesi i njohur më datë 28.04.2022 është dorëzuar denoncim me pohime për organizimit të iftarit nga ana e Ministrisë së ----- dhe është formuar lënda me numër 12-4262/1 të datës 28.04.2022.

Në denoncim parashtruesi thekson se Ministria e -----ka organizuar iftare në një hotel dhe kërkon nga KSHPK-ja që ta vërteton se kush e ka paguar të njëjtën.

Me qëllim kontrollimin e pohimeve dhe përcaktimin e gjendjes faktike në rastin konkret, KSHPK-ja dorëzoi kërkesë për grumbullimin e informacioneve nga Ministria e -----, nga e cila është dorëzuar njoftim se Ministria nuk ka shfrytëzuar mjete buxhetore për organizimin dhe pagesën e iftarit.

Në bazë të sa më sipër, KSHPK-ja konstatoi se nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm sipas lëndës për arsye se pohimet nga denoncimi nuk janë vërtetuar, dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dorëzuar:
- Parashtruesi i denoncimit

PЃrgatiti: B.K.SH
Miratoi: S.P.D anЃtar i KSHPK-sЃ

**KOMISIONI SHTETЃROР PЃR
PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT**

**NЃnkryetar,
Katica Nikolovska**

